



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:033785
Datë: 27.06.2024
Numri i dokumentit: 05865581

Ac.nr.4089/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Nora Bllaca-Dula, kryetare e kolegjit, Halide Reka dhe Ylber Shurdhiqi, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike-kontestimore të paditëses A.K nga Gj....., të cilën e përfaqëson F.M, avokat nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit-Drejtorisë Komunale e Arsimit, të cilën e përfaqëson Burim Maliqi, për pagesën shpenzimeve për ushqim, shpërblimit jubilar dhe diferencës në pagë, duke vendosur në lidhje me ankesën e të paditurës të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan–Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.617/20, i datës 13.05.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 19.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Gjilanit –Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.617/20, i datës 13.05.2022, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.617/20, i datës 13.05.2022 ka vendosur si në vijim: “ *I.APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses A.K nga Gj..... dhe OBLIGOHET e paditura Komuna e Gjilanit — Drejtoria Komunale për Arsim në Gjilan, që paditëses t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 4.629,74 € edhe atë:*

-në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqim gjatë kohës së punës, për periudhën prej 18.04.2017 deri më 21.01.2021, pra për 617 ditë pune, nga 2,00 € në ditë, përkatësisht shumën prej 1.234,00 €.

-në emër të shpërblimit jubilar, për 10 vjet përvojë pune, shumën prej 210,50 € (50% të pagës së saj bazë) dhe

-në emër të diferencës në pagë, për shkak të kualifikimit, për periudhën prej 18.04.2017 deri më 21.01.2021 (89,03 € në muaj), përkatësisht shumën prej 3.185,24 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditë, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur të njëjtën që nga dita e ushtrimit të padisë 04.03.2020 deri në pagesën përfundimtare.

II.OBLIGOHET e paditura që paditëses t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumën prej 516,00 €, në afat prej 7 ditë, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi”.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, ankesën ta aprovojë si të bazuar, ashtu që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të prishet si i pabazuar dhe ta refuzojë në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë në këtë çështje juridike si të pabazuar në ligj dhe çështja të kthehet në rigjykim ose rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar paditësja.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, përmes të autorizuarit të saj, me datë 04.03.2020 në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi, të precizuar me parashtrësën e datës 19.11.2021 me të cilën ka kërkuar kompensimin e pagës jubilarë, shujtë dhe diferencës në pagë për gradim, në shumën e përgjithshme prej 4.628,79 të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të pasojave juridike si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, me arsyet si në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses dhe precizimit të saj, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.617/20, i datës 13.05.2022, me të cilin e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se erdhi në përfundim se kërkesëpadija e paditëses është e bazuar dhe të njëjtën e ka aprovuar, pasi që nga provat e administruara theksuar se nuk është kontestuese fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura edhe atë prej datës 01.10.2011 deri me datë 31.08.2012 ka punuar në SHFMU "....." në Gj....., ndërkaq prej datës 01.09.2012 e këtej është duke punuar në SHFMU "....." në Gj..... dhe se 10 vjet përvojë pune i ka mbushur në ditën e lëshimit të vërtetimit nr.123/21 të datës 06.10.2021, fakt ky i cili është vërtetuar edhe në bazë të Kontratës për punë nr.964 të datës 01.09.2015. Në bazë të vërtetimeve të lartpërmendura paditësja në periudhën prej

18.04.2017 deri më 21.01.2021, gjithsej në punë i ka kaluar 617 ditë pune. Në bazë të Diplomës së fakultetit të arteve në P..... nr.397, prej 26.07.2010, shihet se paditësja i ka kryer studimet bachelor me titull bachelor i pikturës (piktor i diplomuar me 180 kredit ECTS), ndërkaq në bazë të Diplomës nr.289 prej 02.09.2013 të të njëjtit fakultet, paditësja ka kryer studimet Master me titull Master i pikturës, në bazë të Licencës nr.100001144 të MASHT-it, paditësja me datë 11.09.2012 e ka fituar licencën e arsimitarit e vlefshme deri me datë 11.09.2017, ndërkaq në bazë të listës së pagave për muajin qershor 2021 shihet se paga bazë e paditëses është 421,00 €, se merr pagë shtesë për shkak të kualifikimit shumë prej 58,32 € dhe se është anëtare e SBASHK-ut. Lartësinë e diferencës në pagë, për shkak të pagesës më të vogël të pagës shtesë në emër të kualifikimit, gjykata e ka vërtetuar në bazë të ekspertizës financiare të datës 10.02.2022, të cilën palët nuk e kanë kundërshtuar. Duke u nisur nga fakti se paditësja në bazë të vërtetimeve për ditët e punës me nr. protokollin 25/2020 prej 02.03.2020 dhe 138/21 prej 01.11.2011, në periudhën prej 18.04.2017 deri më 21.01.2021, ka qenë në punë gjithsej 617 ditë pune, ndërkaq sipas KKAK kompensimi në emër të shpenzimeve për ushqim për një ditë pune është 2.00 €, e në anën tjetër është vërtetuar se e paditura nuk ka kuzhinë në shkollë dhe as nuk e ka siguruar ushqimin e të punësuarve në ndonjë mënyrë tjetër, është e obliguar që paditëses t'ia paguajë shpenzimet për ushqim në shumë e lartcekur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Duke u nisur nga fakti se paditësja në ditën e lëshimit të vërtetimit për përvojën e punës nr.123/21 prej 06.10.2021 i ka pasur 10 vjet përvojë pune, rezulton se e njëjta 10 vjet përvojë pune i ka mbushur me datë 01.10.2021, mirëpo, duke e pasur parasysh faktin se pagesa e shpërblimit jubilar bëhet me rastin e 7 Marsit të çdo viti, rezulton se e paditura ka qenë e obliguar që paditëses t'ia paguajë shpërblimin jubilar më së voni me 7 Mars të vitit 2021, por që nuk e ka bërë. Andaj, për këtë arsye e paditura është e obliguar që paditëses t'ia paguajë shumë e gjykuar në emër të kompensimit të shpërblimit jubilar për 10 vjet përvojë pune, shujtës si dhe diferencës në pagë për shkak të gradimit, si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Lidhur me pretendimin për parashkrimin e kërkesës gjykata e shkallës së parë e refuzoi si të pabazuar sepse paditësja padinë e ka ushtruar me dt. 04.03.2020, pra brenda afatit kohor të paraparë me ligj, respektivisht me nenin 87 të Ligjit të Punës, i cili shprehimisht parasheh se: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda afatit prej tri vitesh nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, andaj rezulton se padia e paditëses është parashtruar brenda afatit ligjor prej 3 viteve, dhe rrjedhimisht kërkesëpadia e paditëses nuk është përfshirë në parashkrim ashtu siç pretendon e paditura.

Lidhur me mënyrën e vendosjes gjykata e shkallës së parë vendimin e ka mbështetur në nenin 35 paragrafi 7, 8 pika 8.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit 18.04.2017 të datës dhe nenit 7 dhe neni 2 paragrafi 1, 1.2 dhe 1.3 të Kontratës Kolektive të Arsimit, dhe nenit 33 paragrafi 1 pika 1.1 të UA për Sistemin e Licencimit dhe Zhvillimit të Mësimdhënësve në Karrierë.

Gjykata për kamatën ka vendosur duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Vendimin për shpenzimet e procedurës e ka marrë konform nenit 453 të LPK-së dhe nr. tarifor 6 dhe 7 të Rregullores për Tarifatat e Avokatëve, të datës 18.03.2017.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i Gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, gjendja faktike është vlerësuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë.

Pretendimet e të paditurës se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në parashkrim të në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n) sepse dispozitivi i aktgjykimit është kontradiktor me vetveten dhe arsyetimin si dhe i njëjti nuk mund të ekzaminohet nuk qëndrojnë. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plot me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Po ashtu nuk qëndron as pretendimi i të paditurës se kjo kontratë nuk prodhon efekt juridik dhe nuk krijon të drejta dhe detyrime ndaj Komunës së Gjilanit, për shkak se me kontratë kolektive më saktësisht me nenin 46 të saj është përcaktuar se: *“1. MASHT dhe SBASHK, angazhohen bashkërisht për t' i informuar dhe ndihmuar Komunat që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe koston financiare për zbatimin e dispozitave të nenit 35 paragrafët 5, 7 dhe 9”*, ndërsa me paragrafin 2 të po këtij neni është përcaktuar se: *“2.MASHT dhe SBASHK, angazhohen bashkërisht në Ministrinë e Financave për sigurimin dhe ndarjen e mjeteve financiare për Komunat e Republikës së Kosovës, me qëllim të realizimit të buxhetit të nevojshëm të përcaktuar në nenit 35 paragrafët 5, 7 dhe 9, brenda mundësive institucionale, ligjore dhe financiare”*, andaj nuk mund të vihet në përfundim se kjo kontratë nuk prodhon efekt juridik për komunat.

Me nënshkrimin e Kontratës Kolektive nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe përfaqësuesit të paditësve të sektorit të arsimit, Ministria ka marrë obligime në emër dhe llogari të të paditurës, ndërsa obligimi për kompensim bie mbi të paditurën pasi është punëdhënës i paditëses. Koordinimi ndërmjet nivelit lokal (Komunës) dhe nivelit qendror (Qeverisë-Ministrisë) nuk afekton në të drejtën e paditëses.

Gjykata e Apelit vlerëson se kërkesëpadia e paditëses lidhur me kompensimin e ushqimit gjen mbështetje në nenin 35 paragrafi 7, të Kontratës Kolektive të Arsimit ku theksohet se: *“Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet e arsimore.* Duke pasur parasysh se paditësi ka gjithsej 617 ditë të pranisë në punë, shihet qartë se paditëses i takon shpërblimi i vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe se Gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejt dhe në përputhje me Kontratën Kolektive të Arsimit, lidhur me të drejtën e paditëses për kompensimin e ushqimit për faktin se e paditura ka vepruar në kundërshtim me

nenin e sipërcituar, duke mos ia kompensuar paditëses shpenzimet e ushqimit që i takojnë, sipas KKA-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale kur ka gjykuar për shpërblim jubilar dhe kompensim për ushqim në ditët e pranisë në punës për arsye se: Me nenin 90 paragrafi 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: *”Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet : a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”*. Me paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet: a) në nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) në nivel të ndërmarrjes”*. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës”*. Me paragrafin 4 përcaktohet se: *“ Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive”*. Me dispozitën e nenit 35 paragrafi 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të dt. 18.04.2017, përcaktohet se: *“punëtorët (anëtar të SBASH-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblim jubilar nga punëdhënësi i tyre i fundit, për 10 vite të përvojës së punës në vlerë të 50% të një pagë bazë, për 20 vite të përvojës së punës në vlerë të 75% të një page bazë, për 30 vite të përvojës së punës në vlerë të një page bazë dhe për 40 vite të përvojës së punës në vlerë të 150% të një page bazë”* e në rastin konkret paditësja 10 vite të përvojës së punës i ka arritur brenda afatit kohor të kontratës kolektive e cila është vërtetuar nga vërtetimi nr.123/21 prej 06.10.2021 e cila i ka mbushur me datë 01.10.2021. Andaj, për kompensimin e pagës jubilarë drejtë është vendosur shuma prej 210.50 € për 10 vite përvojë pune të paditëses.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se në këtë rast ekziston detyrimi juridiko - civil, ndaj paditëses për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit – shujtës, pagës jubilarë dhe diferencës së pagës për gradim për arsye se me nenin 245 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*. E paditura, Komuna e Gjilanit në ankesë pretendon se gjykata ka vendosur gabimisht sa i përket kërkesës për diferencë në pagë, pasi që sipas të paditurës një e drejtë e tillë nuk i takon paditëses, sepse paditësja nuk është dëmtuar në realizimin e të ardhurave personale dhe se paguhet konform koeficientit të paraparë me konkurs për pozitën që ka krijuar marrëdhënie pune. E paditura tutje ka shtuar se pagesa e paditëses është në harmoni me kontratën e punës të cilën vetë paditësja e ka lidhur me rastin e themelimit të marrëdhënies së punës, dhe se me rastin e themelimit të marrëdhënies së punës në konkurse të publikuara nga DKA askund nuk ceket se i punësuar do të paguhet me shtesë mbi pagën bazë sipas kualifikimit po do të paguhet sipas pagës së paraparë në konkurs.

Gjykata e Apelit i vlerësoi pretendimet e mësipërme ankimore, por vlerëson se të njëjtat nuk qëndrojnë dhe se nuk kanë peshë në vendimmarrje ndryshe nga ajo që është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për faktin se nga shkresat e lëndës rezulton të provohet fakti se

paditëses me aktvendimin mbi licensimin e mësimdhënësës të lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, me nr. të protokollit 100001144 i është pranuar kërkesa për licensim.

Qeveria e Republikës së Kosovës me vendimin, nr.01/33, i datës 29.08.2008 në pikën 1 ka vendosur që: *Nga 1 shtatori i vitit 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës do të kenë rritje të pagave në bazë të kriterëve të licensimit, ndërsa pika 4 ka përcaktuar se: “Mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional të pajisur: 1) Me diplomë të shkollës normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2) Me diplomë të shkollës së lartë pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19% 3) Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27%, 4) Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”*

Nga provat që gjenden në shkresat e lëndës vërtetohet fakti se paditësja ka diplomë universitare, ku edhe ka marrë titullim bachelor i programit të edukimit, ndërsa nga lista e pagave vërtetohet se paditësja ka pagën bazë në shumë prej 421 euro, kualifikimin me fakultet, ndërsa diferenca i është paguar në shumë prej 58,32 euro.

Në rastin konkret, Gjykata e Apelit vlerëson se drejtë është vendosur kur paditësja i është aprovuar kërkesëpadia edhe lidhur me kompensimin e diferencës në pagë në emër të licensimit, ani pse Gjykata e Shkallës së parë është thirrur se kjo e drejtë është përcaktuar me Kontratën Kolektive të Arsimit, kjo Gjykatë vlerëson se kjo e drejtë nuk derivon nga Kontrata Kolektive e Arsimit edhe pse është e përcaktuar me të. Ky përfundim i Gjykatës së Apelit, vie edhe nga *Mendimi Juridik i Gjykatës Supreme të Kosovës, G.J.A-Su.A, 214/2023, i datës 05.10.2023*, ku është përcaktuar se për kërkesa e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licensimit) kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.01/33, i datës 29.08.2008.

Pra vendimi i Qeverisë së RKS, ka qenë në fuqi deri me datën 06.02.2023 deri në periudhën kur edhe është shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik, Nr.08/L-196 dhe ky vendim është dashur që të zbatohet që nga dita e nënshkrimit e deri në momentin kur ka qenë në fuqi, e që e paditura duke vepruar në kundërshtim me këtë vendim ia ka mohuar paditësja një të drejtë që i ka takuar.

Gjykata e Apelit gjen se lidhur me kompensimin e diferencës në pagë në bazë të licensimit, Gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë edhe ekspertizën financiare, në të cilën ekspertizë gjatë kalkulimit të shumës që detyrohet e paditura ta paguaj në emër të kompensimit për licensim është zbritur edhe shuma prej 58,32 euro, e cila shumë është paguar çdo muaj pasi që edhe figuron në listën e pagave.

Paditësja duke qenë se ka kualifikimin me diplomë universitare të njëjtës i takon kompensimi prej 27% të ngritjes të pagës bazë. Gjykata e Apelit ekspertizën e punuar nga eksperti financiar e vlerëson si objektive, profesionale dhe të punuar në përputhje me detyrat ashtu siç është udhëzuar nga Gjykata e shkallës së parë, e po ashtu në përputhje edhe me shkresat e lëndës, andaj ia fal besimin në tërësi.

Kjo Gjykatë gjen se shuma e aprovuar është në përputhje me përqindjen në bazë të kualifikimit, pastaj duke u llogaritur edhe kontributet dhe tatimet shtesë si dhe duke e zbritur shumën prej 58,32 euro, si shumë e cila është paguar vazhdimisht nga ana e të paditurës.

Gjykata e Apelit vlerëson se çështja e asaj se paditësja paguhet sipas kontratës së punës që është lidhur dhe se me konkurs nuk është përcaktuar se mësimdhënësit paguhet sipas licensimit, ky pretendim është tejet irrelevant, pasi që kemi një Vendim të vetë Qeverisë së Republikës së Kosovës që ka pasur karakter detyrues dhe si i tillë është dashur detyrimisht të zbatohet, pavarësisht asaj se çka është përcaktuar me kontratë sepse me kontratë përcaktohet fillimisht paga bazë, ndërsa sa i përket konkursit, kjo është çështje që më tepër ka rëndësi të thirrjes për aplikim të personave të interesuar dhe informim i kushteve që duhet të plotësohen për tu punësuar në institucionin e caktuar, por asnjëherë nuk mund të jetë përcaktues i pagës, shtesave apo edhe kushteve të tjera të punonjësit që përcaktohen me Ligj apo vendime të organeve të Republikës së Kosovës.

Kjo Gjykatë pati parasysh edhe pretendimet lidhur me parashkrimin e kërkesës, por vlerëson se as ky pretendim nuk qëndron pasi që paditësja kërkesën e saj e ka parashtruar brenda periudhës kohore 3 vjeçare të përcaktuar me Ligjin e Punës, më konkretisht me nenin 87 ku përcaktohet se: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, ndërsa dispozitat e LMD-së siç ka pretenduar e paditura se janë kërkesa mujore nuk mund të zbatohen në rastin konkret, sepse kemi të bëjmë me kërkesa nga marrëdhënia e punës e të cilat kërkesa janë të rregulluara me Ligjin e Punës, i cili zbatohet në kontestet e kësaj natyre, andaj vjen në shprehje afati 3 vjeçar i parashkrimit, e i cili në rastin konkret nuk ka arritur sepse paditësit e kanë parashtruar kërkesën brenda afatit të përcaktuar me ligj.

Lidhur me kamatën është vendosur konform nenit 382 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese dhe në pajtim me dispozitat e nenit 453 të LPK-së.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.4089/2022, me datë 19.06.2024

Kryetarja e kolegjit,
Nora Bllaca-Dula d.v